

## Shoqata Kristiane e Grave Shqiptare (YWCA of Albania)

Shoqata Kristiane e Grave Shqiptare u krijua në vitin 1997, për të kontribuar në fuqizimin e grave dhe të rinjve shqiptar përmes *mbrojtjes së të drejtave* të tyre e të fëmijëve, përmes *formimit* dhe *informimit* mbi çështje me interes të drejtëpërdrejtë për to, përmes *punësimit* dhe *shërbimeve* të posaçme në ndihmë të tyre. Shoqata është degë e YWCA Botërore (World YWCA- organizata e grave dhe vajzave, më e vjetër në botë).



# Fushat e veprimtarisë

- Shëndeti i grave, të rinjve dhe fëmijëve
- Të drejtat e njeriut (gratë, të rinjtë dhe fëmijët)
- Edukim
- Formimi profesional
- Punësim për gra dhe vajza
- Shërbime për gratë dhe fëmijët

# Shëndeti i Grave dhe të Rinjve

- Prej mëse 17 vitesh, YWCA ka hartuar dhe zbaton një program të gjerë **edukimi shëndetësor**, i përqëndruar kryesisht në informim, ndërgjegjësim e parandalim për çështje të *shëndetit riprodhues*, të *shëndetit seksual*, si dhe problemet e *HIV/AIDS-it*.

YWCA në bashkëpunim me UNAIDS, UNFPA dhe World YWCA ka krijuar dhe ngritur tashmë iniciativën ***“Krijimi i partneriteteve dhe mekanizmave ndërmjet OJF në nivel lokal/rajonal për të kontribuar tek politikat lokale përsa i përket rinisë dhe shëndetit riprodhues”***. Qëllimi i kësaj nisme është të krijojë një ambient mbështetës për OJF-të cilat punojnë dhe ofrojnë shërbime për grupet e marginalizuara dhe ato në risk. Krijimi i partneritetit të shoqërisë civile dhe pushtetit lokal do të lehtësonte adresimin e problematikave të këtyre grupeve si dhe ofrimin e shërbimeve sa më afër komuniteteve. Jane krijuar disa rrjete partneritetesh përkatësisht në Bashkitë: Shkodër, Elbasan, Vlorë, Berat, Lezhë dhe Kukës.

# Shëndeti i Grave dhe të Rinjve



➤ Pjesë e rëndësishme e programit të edukimit shëndetësor të Shoqatës është bërë, që prej vitit 2009, edhe informimi, ndërgjegjësimi e parandalimi i ***kancerit të gjirit te gratë***. Për këtë ka ndikuar fakti që numri i grave dhe vajzave të prekura prej kancerit të gjirit në vendin tonë, sipas statistikave zyrtare, po rritet gjithnjë e më shumë, duke përbërë dhe shkakun kryesor të vdekjeve të tyre.

# Të drejtat e njeriut



Me qindra gra e vajza prej komunitetit rom e ballkano-egjiptian, gra e vajza të fshatit, ato që kanë migruar prej zonave veriore e verilindore të Shqipërisë e janë vendosur në periferi të kryeqytetit e qyteteve të tjera të mëdha të vendit, ish-të trafikuar dhe gra me liri të kufizuar (gra të burgosura) kanë ndjekur seminare e kurse trajnimi për t'u njohur me të drejtat e tyre si të drejta të njeriut.

*YWCA është e angazhuar aktivisht në çështjen e të drejtave të grave e të fëmijëve në kuadrin e të drejtave të njeriut.*

# Edukim, Formim Profesional dhe Qendër Punësimi

➤ Duke njohur rëndësinë e jashtëzakonshme të librit për zhvillimin e aftësive të fëmijëve që në vitet e para të jetës së tyre është ndërmarrë, në bashkëpunim me UNICEF-in dhe Ministrinë e Arsimit, zbatimi i projekteve: ***“Shqipëria lexon”*** dhe ***“Çdo fëmijë rom në kopsht”***

➤ YWCA i përmbahet fort idesë se fuqizimi i vërtetë i grave e i vajzave mund të arrihet vetëm kur ato fuqizohen edhe ekonomikisht. Në këtë kuadër shoqata ofron rregullisht **kurse trajnimi profesional: *kurse trajnimi për bebisiter*** dhe ***kurse trajnimi për punëtore pastrimi***.

➤ Qendra e punësimit ndërmjetëson për punësimin e grave e të vajzave të trajnuara si bebisiter dhe punëtore shtëpie.



# Shërbime për gra dhe fëmijë

- Është ngritur një **Qendër e kujdesit ditor për fëmijë** të moshës parashkollore (3-6 vjec), ku kujdesi, edukimi, argëtimi dhe shoqërizimi i tyre realizohet sipas një programi dhe sipas metodash didaktike bashkëkohore.

- Një **Bibliotekë për gra dhe të rinj**— e para dhe deri më sot e vetmja bibliotekë e këtij lloji — gjendet në mjediset e Shoqatës. Mbi 3000 tituj librash, por edhe revista e gazeta në shqip e në gjuhë të huaja janë në dispozicion të grave e të vajzave.





## YWCA ofron

YWCA është e gatshme të kontribuojë në Rrjetin e të rinjve, duke vazhduar të ofrojë programet edukuese dhe informuese me fokus të rinjtë dhe nevojat e tyre e vecanërisht ata të grupeve në nevojë.

Një ndihmë të veçantë në këtë proces do të japin Partneritetet lokale në të 6 bashkitë që kanë në fokus të rinjtë, të cilat do të shërbejnë si një mundësi për të advokuar dhe lobuar për zgjidhje për çështjet që shqetësojnë të rinjtë. Gjithashtu këto struktura do të shërbejnë për të ngritur kapacitetet e grupimeve dhe shoqatave lokale rinore.





***FALEMINDERIT!***